

RAPORT I



PERFORMANCËS SË  
KOMUNAVE TË

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

J A N A R – D H J E T O R 2 0 2 2

**Institucioni:**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

**Mbikëqyrja:**

Drin Haraqia, Udhëheqës i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale MAPL

**Pjesa e përgjithshme hartuar nga:**

Haxhi Krasniqi, U.D i Udhëheqësit për Performancë Komunale;

**Pjesa e veçantë nga:**

Haxhi Krasniqi & Lazar Mitic

**Mbledhja, përpunimi, verifikimi i të dhënave:**

Haxhi Krasniqi, U.D i Udhëheqësit për Performancë Komunale;MAPL

Lazar Mitic, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Edina Ibishi, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Shqiponja Vokshi, DEMOS

Blerta Sejdiu – Junior Konsulente/DEMOS

Edita Azemi – Praktikante/DEMOS

## Përmbajtja

HYRJE .....	4
BAZA JURIDIKE PËR RAPORTIN E PERFORMANCËS.....	4
QËLLIMI.....	5
METODOLOGJIA.....	5
Kapitulli I .....	6
I. Performanca e komunave 2022 – Pjesa e Përgjithshme .....	6
1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I MATJES SË PERFORMANCËS KOMUNALE.....	6
2. TRENDET E PERFORMANCËS SË KOMUNAVE NDËR VITE .....	7
REZULTATET E VITIT 2022 .....	7
Kapitulli II .....	12
II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2022.....	12
1. REZULTATET E KOMUNAVE SIPAS FUSHAVE DHE TREGUESVE .....	12
Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative.....	12
Fusha 2 – Transparenca Komunale .....	13
Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale.....	15
Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare .....	17
Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport.....	18
Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive.....	19
Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor .....	20
Fusha 8 – Hapësirat Publike .....	21
Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore.....	22
Fusha 10 – Transporti Publik.....	23
Fusha 11 – Parkingjet Publike .....	24
Fusha 12 - Uji i pijshëm.....	25
Fusha 13 - Kanalizimi .....	26
Fusha 14 – Menaxhimi i Mbeturinave .....	27
Fusha 15 – Mbrojtja e Mjedisit .....	28
Fusha 16 – Përfaqësimi Gjinator .....	29
Fusha 17 - Arsimi Parauniversitar .....	30
Fusha 18 – Kujdesi Primar Shëndetësor .....	32
Fusha 19 – Zhvillimi Ekonomik Lokal .....	33
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....	35
SHTOJCË: % E TREGUESVE SIPAS FUSHAVE .....	37

## Hyrje

Raporti i performancës komunale për vitin 2022 prezanton rezultatet e punës së komunave në 19 fushave të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre, përmes 111 treguesve nga 119 sa ka gjithsej Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale.

Vlerësimi i treguesve të aplikueshëm është bërë në koordinim me zyrtarët komunal, me të cilët para procesit të matjes është realizuar një konsultim i përgjithshëm, duke evidentuar treguesit e mundshëm dhe pezulluar 9 prej tyre.

Raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre është bërë përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Qasje në këtë sistem kishin të gjithë zyrtarët raportues të komunave, koordinatorët e performancës, kryetarët e komunave dhe zyrtarët vlerësues të Ministrisë. Krahas raportimit, sistemi ofroi mundësinë e bashkëngjitjes së dokumenteve referuese për të dhënat e raportuara, si dhe një proces komunikimi në mes të komunave dhe Ministrisë, duke lënë gjurmë në secilën fazë të vlerësimit të të dhënave.

Ky raport synon të pasqyroj dy aspekte kryesore të punës së komunave:

- 1) Mënyrën e qeverisjes së komunave bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe
- 2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor, kur është e mundur.

Të dhënat e ofruara shërbejnë për të parë trendët e zhvillimit të komunave nga viti në vit, në mënyrë që prioritetet e vijuese të shtrihen në mbështetje të sektorëve më pak të organizuar. Veç kësaj, rezultatet e raportit shërbejnë si mjet vetëkontrolli për punën e administratës komunale, për të rritur kapacitetet dhe reflektuar në përgjegjshmërinë e zyrtarëve publik. Për më tepër, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet dhe të zgjedhurit e tyre lokal.

Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse.

Për vitin 2022 kanë raportuar 30 komuna të Republikës së Kosovës<sup>1</sup>.

## Baza juridike për raportin e performancës

Matja e performancës komunale tashmë është ngritur në nivel të rregullimit ligjor. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar Ligjin Nr. 08/l-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë, i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 12.08.2022. Në vitin 2023, ka hyrë në fuqi Udhëzim Administrativ Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe Skemën e grantit për performancë komunale.

Sipas nenit 19, të ligjit procesi i matjes së performancës organizohet në baza të rregullta vjetore nga Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal. Në nenin 19 të Ligjit për SMPK dhe GPK, është i përcaktuar afati i raportimit të të dhënave komunale në SEMPK.

Për më saktë, *“Procedurat dhe afatet tjera për matjen e performancës dhe vlerësimin për grant përfundojnë në pajtim me rregullat juridike që janë përcaktura me Udhëzim Administrativ.*

Referuar Ligjit Nr. 08/l-103, SMPK është i ndërtuar mbi bazën e parimeve themelore siç janë: Ligjshmërisë; Transparencës; Subsidiaritetit, meritës; objektivitetit dhe paanshmërsisë; Barazisë dhe mosdiskriminimit;

---

<sup>1</sup> Të dhënat nuk janë raportuar nga Komuna e Ferizajit, Shtërpeces, Novobërdës, Mitrovicës së Jugut, Zubin Poptokut, Leposaviqit, Zveqanit dhe Kllokot

Udhëzimi përcakton të drejtën e autoritetit mbikëqyrës për të kërkuar informata të cilat i shërbejnë matjes dhe vlerësimit të performancës së komunave. Udhëzimi përcakton strukturat organizative përgjegjëse të komunave për raportim në kuadër të SMPK-së.

#### Qëllimi

Matja e performancës ka për qëllim përcjelljen sistematike të ngjarjeve dhe aktiviteteve të komunave brenda kornizës së treguesve të caktuar. Qëllimi i kësaj matje është të nxjerr në pah fushat ku shërbimet komunale kanë nevojë për mbështetje dhe avancim, si dhe fushat ku duhet orientuar ndërhyrjet afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata.

Të dhënat e fituara ndihmojnë që komunat të përmirësojnë planifikimin dhe të orientojnë prioritetet e tyre në sektorët e nevojshëm për vitet e ardhshme.

Në fakt, matja e performancës synon të jap përgjigje në pyetjet se:

- Në çfarë niveli kanë performuar komunat?
- Nëse komunat po i arrijnë objektivat e tyre?
- Nëse proceset menaxhuese janë në pajtim me ligjin?
- Cilat duhet të jenë veprimet e nevojshme që duhet bërë në të ardhmen?

Sistemi shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar dhe orientuar politikën në sektorët në nevojë, sipas vlerësimeve reale, kritereve të qarta, ashtu që shpërndarja e investimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe objektive. Në këtë drejtim, qëllimi i matjes shërben edhe për nevojat të Grantit të Performancës Komunale, pasi tërësia e treguesve të këtij granti, shërbehet me të dhënat e raportit të performancës komunale.

Prandaj, të dy këto procese, matja e performancës dhe ndarja e grantit për performancë, synojnë të përmirësojnë punën e administratës komunale në përgjithësi, të rrisin nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, si dhe të reflektojnë në qeverisje më të mirë dhe shërbime sa më cilësore për qytetarë.

#### Metodologjia

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) është i ndërtuar nga MAPL në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtar. MAPL ka përcaktuar dhe normuar metodologjinë për përgatitjen, mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në SMPK.

Udhëzimet për mbledhje dhe raportim të të dhënave janë dhënë përmes: trajnimeve për koordinatorët komunal për performancë dhe zyrtarët raportues. Në hap me këtë janë përgatitur udhëzimet e shkruara të cilat shpjegojnë në detaje gjithë skenarin e funksionimit të SMPK-në.

Procesi i matjes së performancës ka kaluar nëpër fazat e mëposhtme:

1. Funksionalizimin e sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të performancës dhe mbajtjen e trajnimeve për të gjithë zyrtarët e komunave;
2. Hapjen e thirrjes për raportim në komuna;
3. Pranimin e të dhënave të raportuara nga komuna;
4. Mbrenda afatit për raportim është bërë verifikimin paraprak i të dhënave;
5. Adresimi i ndryshimeve eventuale në sistem, pas verifikimit paraprak;
6. Verifikimin e të dhënave me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në teren;
7. Verifikimin e rregullt sipas mostres prej 11 treguesve
8. Nxjerrjen dhe komunikimin preliminar të rezultateve të performancës në komuna;
9. Përmbylljen e periudhës së ankesave;
10. Finalizimin e raportit;

Raportimi dhe dokumentimi i të dhënave për SMPK është bërë në Sistemin Elektronik të SMPK-së nga komunat, pas udhëzimeve/trajnimeve të organizuara nga MAPL dhe DEMOS. Procesi i mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave brenda institucioneve të ndryshme komunale është koordinuar nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara janë autorizuar nga kryetarët e komunave.

**Verifikimi i të dhënave** – sigurimi i cilësisë së të dhënave dhe verifikimi i tyre është bërë përmes disa metodave:

- Dokumentimit përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare;
- Shqyrtimit të dokumenteve zyrtare të bashkëlidhura me formularët e plotësuar në sistemin elektronik;
- Sqarimeve të ofruara nga koordinatorët në Sistemin Elektronik të Performancës;
- Krahasimit të të dhënave me dokumente të tjera zyrtare të institucioneve publike;
- Krahasimit me raportet e tjera zyrtare të MAPL-së;
- Për të dhëna të caktuara janë kontaktuar direkt zyrtarët përgjegjës në komuna

## Kapitulli I

### I. Performanca e komunave 2022 – Pjesa e Përgjithshme

#### 1. Vështrim i përgjithshëm i matjes së performancës komunale

Matja e performancës së komunave është proces i rregullt i cili implementohet në Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse në komunë, duke përfshirë zyrtarët raportues, koordinatorët e performancës dhe kryetarët e komunave, si autorizues të fundit të të dhënave të raportuara nga komunat.

Matja shtrihet brenda kornizës së kompetencave të komunave sipas legjislacionit bazë dhe atij sektorial. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje lokale ka përcaktuar në mënyrë taksative kompetencat e komunave në fusha të shumta të qeverisjes lokale, përfshirë: shërbimet publike, infrastrukturën lokale, mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, ndriçimin publik, zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe ndërtimin, furnizimin me ujë të pijshëm, rrjetin e kanalizimit, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, ofrimin e arsimit parauniversitar, shëndetësinë primare, shërbime të mirëqenies sociale, aktivitetet kulturore, si dhe shumë çështje të tjera të përcaktuara shprehimisht me ligj.

Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) mundëson që rezultatet e fituara të shërbejnë si mjet identifikimi për aspektet e forta dhe të dobëta të qeverisjes lokale, në mënyrë që nga informacionet e fituara, të ndërtohen strategji për përmirësim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Matja e vitit 2022 është realizuar në 19 fusha të kompetencave komunale, me gjithsej 111 tregues. Elementet e matjes së performancës shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore<sup>2</sup>. Indikatorët e përdorur japin informacione të konsiderueshme për nivelin e shërbimeve të ofruara. Të dhënat e fituara japin indikacione të rëndësishme për menaxhmetin e komunës për të shtrirë prioritetet në sektorët më pak të zhvilluar.

---

<sup>2</sup> Udhëzim Administrativ Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe skemën e grantit për performancë komunale

Edhe në vitin 2022 procesi i matjes së performancës komunale është bërë me anë të Sistemit Elektronik i menaxhimit të Performancës, në të cilin kanë qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave dhe ministrisë. Digjitalizimi i këtij procesi ka mundësuar një formë interaktive të komunikimit, për të qartësuar të gjitha të dhënat diskutabile dhe për të rritur shkallën e dokumentimit. Njëherësh sistemi mundëson gjurmimin e të gjithë hapave të vlerësimit dhe ruan të gjitha dokumentet relevante mbi të cilat bazohet raportimi.

## 2. Trendet e performancës së komunave ndër vite

Në vitin 2022, kërkesës për raportim të performancës janë përgjigjur 30 komuna, nëdërsa 8 komuna tjera nuk i kanë raportuar të dhënat në SMPK. Komuna Kllokotit nuk ka raportuar në kohën e paraparë me ligj dhe ka raportuar vetëm 30% të të dhënave. Rezultatet e tregojnë se niveli i të arriturave të komunave ndër vite varion prej 57.06% deri në 59.38%, në vitin 2022.

Duhet cekur se elementet e matjes së performancës kanë ndryshuar ndër vite, për shkak të përfshirjes së risive brenda SMPK-së, përkatësisht shtimit të treguesve dhe të dhënave të reja. Qëllimi i zgjerimit të fushave dhe treguesve ka qenë që të maten sa më shumë shërbime të mundshme të cilat ofrohen nga ana e institucioneve lokale. Kjo rritje po ashtu është bërë për faktin se komunat kanë forcuar kapacitetet e tyre për përdorimin e sistemit të performancës, duke rritur kualitetin e të dhënave të raportuara. Analizat e përgjithshme tregojnë se disa tregues tanimë kanë arritur një standard të mirë të funksionimit, që dëshmojnë për nivel të rregullsisë brenda rezultateve të synuara. Në anën tjetër ekzistojnë parametra të caktuar për të cilët komunat akoma qëndrojnë në nivel të ulët të zhvillimit, për të cilët treguesit e matjes duhet të jenë prezent në një periudhë afatgjatë.

Më poëshhtë janë paraqitur përqindjet mesatare nga viti 2020 deri në vitin 2022, si në vijim:



**Fig.1.** Performanca e komunave sipas viteve 2020-2022

### Rezultatet e vitit 2022

Sa i përket të dhënave për vitin 2022, performanca e përgjithshme e komunave në 19 fusha me 111 tregues të matjes është 59.38%, që do të thotë se komunat kanë ofruar shërbime në më të lartë se në vitin 2021, për 3.30% krahasuar me 2021, ndërsa krahasuar me vitin 2020 ndonëse ka një ngritje të lehtë të performancës në vitin 2022 prej 2.32%.

Mesatarja e përgjithshme tregon se komunat duhet të rrisin përpjekjet tyre për të përmirësuar shërbimet dhe qeverisjen. Referuar % sipas fushave, nevoja më e madhe për rritjen e performancës shprehet në këto fusha: përfaqësim të barabartë gjinor (39.20%), kanalizim (39.74%), parkingje (47.35%), transport publik (47.41%) hapsirat publike (47.84%) kujdesi parësor shëndetësor (50.81%) mbrojtja e mjedisit (52.19%) menaxhimi i fatëkeqësive (53.68%) infrastruktura rrugore (55.05%) planifikim hapësinor (55.37%), zhvillim

ekonomik lokal (56.38%) dhe shumë afër mesatares së vendit kemi fushën e arsimit parauniversitar me (58.30%)

Në nivelin mbi mesataren e vendit janë shërbimet si në vijim: Shërbime publike Administrative janë në nivelin më të lartë prej 88.04% në nivel vendi, e pasuar nga fusha transparenca komunale 86.11%, Kultura Rina dhe Sporti janë shërbime të cilat janë ofruar në nivel të kënaqëshmëm që shprehur në përqindje janë 83.67%, uji pijshëm është renditur në nivelin katërt prej 74.60%, po ashtu fusha e menaxhimit të mbeturinave ka vlerën prej 69.84%. Dy fushat tjera, përgjegjëshmëria komunale dhe barazia në punësim dhe shërbimet sociale janë shumë afër mesatares së vendit sa i përket ofrimit të këtyre shërbimeve për qytetarë, fusha përgjegjëshmëria komunale ka vlerën 62.41% dhe barazia në punësim dhe shërbimet sociale në vlerën prej 60.30%.

Më poshtë është paraqitur figura me % e arritur të 19 fushave të matjes:





Fig.2. Performanca sipas fushave



**Ndarja e fushave sipas kategorive dhe niveleve të performancës**, në tri nivele i kemi ndarë 19 fushat e qeverisjes nga komunat. Sipas grafikut më lartë, në nivel të lartë të performancës janë pesë (5) fusha të radhitura sipas përqindjes, shërbimet administrative me 88.04% dhe



**Fig. 3** Kategorizimi i fushave sipas nivelit të performancës

menaxhimi i mbeturinave me 69.84%. Shërbimet me nivel të mesëm të performancës janë 12 duke filuar me përgjegjshmërinë komunale me 62.41% dhe me prakringjet publike me 47.35%. Vlenë të theksohet se vetëm dy shërbime janë në nivel të ulët të performancës në nivel vendi. Nga kjo renditje shihet që nuk ka ndryshime nga viti 2021, sepse edhe në vitin 2021 kanë qenë të renditura njësoj sipas performancës komunale, vetëm se vërhet një ndryshim i vogël specifik sipas përqindjes.

Elementet e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale sigurojnë informata edhe për procedura dhe aspekte ligjore të një shërbimi publik, për këtë arsye kategorizimi i fushave për nga niveli arritjeve është bërë duke marrë parasysh qëllimin e treguesve, ngjashmëritë në mes të tyre, përmbajtjes dhe llojit të fushës së kompetencës. Së këndejmi, grupimi i fushave në vijim merr parasysh këto segmente:

- 1) Standardet e qeverisjes së mirë
- 2) Ofrimin e shërbimeve publike

Nga figura 4 vërejmë që në kuadër të treguesve të qeverisjes, në vitin 2022 mesatarja është 65.26%, nga 56.70% sa ishte në vitin 2021. Krahasuar me vitin paraprak, të dhënat tregojnë se komunat kanë rritur efikasitetin në ofrimin e **shërbimeve administrative**, prej 81.66% në 88.06%, apo 6.4% më shumë. Në kuadër të kësaj fushe vlerësohet efikasiteti i komunave në kthimin e përgjigjeve palëve në procedurë administrative, trajtimit të tyre brenda afateve ligjore si dhe ofrimin të shërbimeve administrative në formë elektronike<sup>3</sup>.

<sup>3</sup> Per me teper: <https://mapl.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2021/05/Dokumenti-Kryesor-i-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Performances-Komunale- designed-18.02.2021.pdf>, fq. 62

### 1) Standardet e qeverisjes së mirë

Në kuadër të **Transparencës komunale**, niveli i përgjithshëm i të arriturave shprehet me 86.11%, nga 66.92% sa ishte në vitin 2021, apo 19.19% më e lartë se në vitin 2021. Sipas të dhënave, për fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor, megjithëse mbetet ndër fushat me përqindjen më të ulët (38.02%), për vitin 2021, kemi në ngritje të lehtë të performancës për këtë fushë prej 39.20 apo 1.18 më e lartë se në me praparak.




Fig. 4 % e arritur në fushat e qeverisjes


Transparenca komunale lidhet ngushtë me fushën e **përgjegjshmërisë komunale**, e cila vlerësohet me numrin më të madh të treguesve në kuadër të SMPK-së. Për dallim nga treguesit e transparencës të cilët kryesisht janë të orientuar në ofrimin e publicitetit për aktivitetet dhe të dhënave zyrtare, përgjegjshmëria komunale inkorporon të dhëna që tregojnë për nivelin e llogaridhënies së organeve komunale, si dhe aktivitet e tyre për përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Përderisa komunitat qendrojnë mjaft mirë në treguesit e transparencës, rezultatet e përgjegjshmërisë tregojnë për nevojën e fuqizimit të elementeve të llogaridhënies dhe përfshirjes më të madhe të qytetarëve. Kjo fushë rezulton me (62.02%) dhe ka performancë të njëjtë me vitin 2021.

Në kuadër të veprimeve që **ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal** komunitat kanë performancë me nivel të përgjithshëm të të arriturave në shkallën 56.38%, edhe kjo fushë ka nivel të njëjtë të aritjes së performancës krahasuar me vitin 2021.

**Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare** - Në kuadër të kësaj fushe janë matur veprimet e komunave për ofrimin e banimit social, si dhe kujdesin institucional ndaj grupeve të cënueshme. Po ashtu janë mbledhur të dhëna për punësimin e personave me aftësi të veçanta dhe punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë bazuar në të drejtat ligjore të tyre. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 60.30% krahasuar me 55.09% të vitin paraprak.

### 2) Fushat me tregues për ofrimin e shërbimeve publike.

Në kuadër të këtyre fushave bëjnë pjesë tregues për lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve nga ana e komunave, si në: menaxhim të mbeturinave, furnizim me ujë, mbrojtje të ambientit, kanalizim, planifikim urban, aktivitete kulturore, arsim, shëndetësi, infrastrukturë rrugore, trotuare, ndriçim publik, mirëmbajtje të hapësirave publike, mirëmbajtje të rrugëve, shtigje të biçikletave, parkingje publike, shenjzim të rrugëve etj. Nga figura 5 rezulton që në kuadër të treguesve të shërbimeve publike, mesatarja e përgjithshme e arritur është 56.60%.



**Fig.5.** Performanca e komunave në fushat e matjes së shërbimeve publike gjatë vitit 2022

**Fusha, Kulturë, rini dhe sport**, për vitin **2022** ka shkallën më të lartë të ofrimit të këtij shërbimi në nivel të gjitha komunave, e shprehur në përqindje në vlerën prej 83.67%, e pasuar nga **Uji i pijshëm** që radhitet e dyta prej 74.60%, e treta në renditje është fusha **Menaxhimi i Mbeturinave**, që nivel mjaft të kënaqëshëm të ofrimit të këtij shërbimi në të gjitha komunat e vendit dhe kapë vlerën 69.84%. sikurse edhe fusha e **Arsimit parauniversitar** si kompetencë vetanake komunale ka një renditje të mirë sa i përket ofrimit të rezultateve në ofrim të shërbimeve komunale me 58.30%. **Planifikimi Hapsinor**, renditet e pesta sa i perket listës së ofrimit të shërbimeve kualitative e cila është shprehur %, ka vlerën 55.37%, dallim të vogël vërejmë edhe në fushën **Infrastruktura rrugore**, e cila në përqindje ka vlerën prej 55.05%, me pas renditet fusha **Menaxhimi i fatkeqësive**, e cila është shprehur në pëqindje në vlerën prej 53.68%. **Mbrojtja e mjedisit** ka nivel mesatar të ofrimit për të gjitha komunat dhe kap vlerën prej 52.19%, e pasuar nga fusha e **Kujdesit parësor shëndetësor**, e cila në përqindje ka vlerën prej 50.81%.

Në nivel pak më të ulët janë fushat si në vijim, duke filluar nga fusha **Hapsirat Publike**, 47.84%, fusha e **Transportit Publik** ka vlerën prej 47.41% e pasuar nga fusha **Parkingjet Publike komunale** që ka vlerën

47.35% dhe e fundit si fushë në nivel vendi renditet fusha e **Kanalizimit** dhe ka vlerën prej 39.74% dhe mund të themi që ka një nivel mesatarë të ofrimit të këtij shërbimi në komuna.

## Kapitulli II

### II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2022

#### 1. Rezultatet e komunave sipas fushave dhe treguesve

Matja e performancës në vitin 2022 ka pasur në fokus pasqyrimin e të arriturave për 38 komuna. Kërkesës për raportim i janë përgjigjur 31 komuna, megjithëse shkalla e pavarshmërisë së të dhënave ishte mjaft e shprehur në disa komuna

Shkalla e ofrimit të shërbimeve dhe respektimit të standardeve të qeverisjes ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, varësisht nga fusha e kompetencave që matet. Në nivelin e performancës mund të ndikojnë faktorë të shumtë, si: prioritetet e vëna nga komuna brenda fushave për të cilat ushtrohet matja, mënyra dhe cilësia e planifikimit të punëve, realizimi në raport me planifikimin, realizimi në raport me mundësitë dhe pengesat e caktuara, kapacitetet dhe resurset, kompleksiteti i çështjeve, cilësia e raportimit të të dhënave në SMPK, si dhe faktorë të tjerë relevant.


Në vijim të këtij raporti, janë paraqitur detaje të të arriturave të komunave sipas fushave dhe treguesve përkatës.

**Sqarim:** Në vijim të raportit, llogaritja e rezultatit përfundimtar të fushave të matjes, merr për bazë edhe vlerën 0 për të dhënat e të cilave janë shpallur të pavlefshme. Kjo është bërë për arsye se edhe keqraportimi konsiderohet performancë e dobët, gjë që duhet të ndikoj në rezultatin përfundimtar të komunave që nuk kanë ofruar të dhëna. Kjo reflekton edhe në krahasimet në mes të komunave si dhe vlerësimet e bëra për qëllime të Grantit për Performancë.

#### **Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative**


Kjo fushë përbëhet nga katër tregues, ku përfshihen shërbimet publike administrative (SHPA) dhe efikasiteti i organeve komunale në shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve, personave fizik dhe juridik, për çështjet që lidhen me kompetencat e tyre të cilat kalojnë nëpërmjet Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve. Njëkohësisht, kjo fushë matë gatishmërinë e komunave për të ofruar shërbime administrative në formën online apo përmes e-kioskut.

Krahasuar me 19 fushat e tjera, në vitin 2022 kjo fushë radhitet e para për nga performanca, me nivel të përgjithshëm prej 88.04%.



**Fig. 6** Krahasimi i performancës së komunave në fushën e shërbimeve administrative

Të dhënat tregojnë se komunat në masë të madhe i kanë shqyrtuar kërkesat administrative të cilat u janë parashtruar. Përmes tre treguesve në SMPK. Tereguesi: kërkesa administrative të shqyrtura gjatë vitit shprehur në % janë 74.40% sikurse kërkesa administrative të shqyrtura brenda afateve ligjore janë 96.66%, kurse shërbime administrative të ofruara online janë po ashtu 74.40%




**Fig. 7** Treguesit e performancës në fushën e shërbimeve administrative

## Fusha 2 – Transparenca Komunale


Në këtë fushë janë aplikuar 7 tregues me 26 të dhëna të cilat japin informata për publikimin e akteve, planeve, buxhetit, kritereve të ueb-faqeve, qasjen në dokumentet publike, publicitetin e seancave të kuvendit, etj.

Performanca e përgjithshme e arritur në këtë fushë është 86.11%, për dallim nga viti paraprak ku ishte 66.92%. Sa u përket performancës sipas tregueseve, përqindja më e lartë është në lejimin e qasjes së qytetarëve në dokumentet zyrtare shprehur me 93.54%.



**Figure 8** Treguesit e performancës në fushën e transparencës

Nga figura e mësipërme shihet se treguesi për transmetimin online të mbledhjeve të kuvendit del në nivel 85.74%, gjë që ndikon edhe në ngritjen e përgjithshme të performancës në këtë fushë. Tetë kriteret e matura për ueb-faqe komunale del të jenë përbushur në masën 83.83%, ndërsa aktet e kuvendit të komunës janë publikuar në shkallë prej 91.12%. Të dhënat tregojnë për trend pozitiv në publikimin e akteve me karakter të përgjithshëm të aprovuara nga kryetarët e komunave, shprehur në përqindje prej 77.86%. Po ashtu, komunat kryesisht kanë qenë efikase në publikimin e buxhetit të komunës si dhe raporteve të shpenzimeve, në nivelin prej 85.33%. Sa i përket publikimit të planit vjetor të




**Fig. 9** Krahasimi i performancës së komunave në fushën e transparencës komunale

prokurimit publik dhe publikimit të kontratave komunat kanë përqindjen prej 86.76% apo 4.36 më e lartë se në vitin 2021

Figura e mësipërme tregon për 6 komuna të cilat kanë treguar performancë në mes 90-100% në fushën e transparencës, prej të cilave: Glllogoc (100.00%), Junik (100.00%) Rahovec (100.00%), Shtime (100.00) Suharekë (100.00%), dhe Mitrovica e Jugut (100.00%).


### Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale

Përgjegjshmëria komunale ka gjithsej 22 tregues, prej të cilëve 18 janë aplikuar në vitin 2022. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 62.41%. Në kuadër të kësaj fushe, vërejmë performancë të lartë të komunave në ndërmarrjen e veprimeve ligjore. Komunat kanë treguar performancë pozitive edhe në diskutimin e projektbuxheteve dhe kornizës afatmesme të shpenzimeve, në këtë tregues komunat janë treguar të suksesshme. Po ashtu komunat kanë arritur performancë të lartë për treguesin Nveli i zbatimit të planit të prokurimit, nivel të konsiderueshëm të lartë ka edhe treguesi, Vende të hapura të punës që janë procesuar përmes SIMBNj.




**Figure 10** Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunale

Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike edhe në vitin 2022, mbetet e ulët edhe përkundër standardit të SMPK-së të 3% të popullsisë së komunës, i cili është përmbushur në shkallën 35.26% krahasuar me vitin paraprak që ishte 21.91%, apo 13.35% më e lartë se në vitin paraprak. Te ky tregues vërehet një ngritje e lehtë në vitin 2022.



**Figure 11** Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunale

Sa i përket nivelit të zbatimit të planit të prokurimit, bazuar në shumën e shpenzuar kundrejt shumës së planifikuar, performanca rezulton në masën 89.63% ,ky tregues ka një ngritje prej 8%,ku në vitin 2021 ishte 81.63%. Treguesi i për nivelin e adresimit te rekomandimeve të ZKA-së ka përqindjen prej 46.67%.



**Figure 12** Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunale






Figure 13 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e përgjegjshmërisë

Performancën më të lartë në indikatorët e kësaj fushe e ka arritur komuna e Rahovecit (92.54%) Lipjanit (92.35%), Gllgoc (89.64%) dhe Kaçanik (87.10%) Ndryshe nga to, më ulët qëndrojnë komunat: Partesh, Mamushë, Graçanicë, Prishtinë dhe Ranillug. Në nivelin të performancë në këtë fushë, ka ndikuar edhe mos raportimi i të gjitha të dhënave për tregues nga komunat në fjalë.

#### Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare

Kjo fushë prej dy rezultateve dhe katër treguesve mbulon përfaqësimin e grupeve të ndryshme në punësim komunal, si dhe shërbimet sociale të grupeve më me nevojë në komuna. Në kuadër të punësimit treguesit matin nivelin e punësimit të personave me aftësi të veçanta në institucionet komunale, si dhe përqindjen e përfshirjes së komuniteteve jo shumicë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë prej 60.30%.




Figure 14 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare




Figure 15 Treguesit e performancës në fushën e Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Sipas të dhënave niveli i përmbushjes së kuotës për të punësuar me nevoja të veçanta mbetet i ulët, referuar kriterit të përcaktuar në Ligjin Nr. 05L-051 për mbrojtje nga diskriminimi. Më poshtë, janë pasqyruar të arriturat për secilën komunë në kuadër të kësaj fushe: Përqindje me e lartë është shënuar në dy tregues, Familje në nevojë të cilave iu është siguruar banimi social, në masën 69.13% dhe fëmijë në nevojë që iu është siguruar strehimi familjarë, në përqindjen prej 90.99%

### Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport

Në kuadër të kësaj fushe maten aktivitetet komunale kulturore, rinore dhe sportive, si një nga kompetencat vetanake të komunave. Fusha mbulon edhe shërbimet e ofruara nga komunat që kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin, përfshirë hapësirat sportive.

Fusha matë performancën duke e krahasuar me numrin e banorëve për arsye që të jetë më e balancuar ndaj komunave me shumë banorë dhe atyre me më pak banorë. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 83.67%.




Figure 16 Treguesit e performancës në fushën kulturë, rini dhe sport

Treguesit, aktivitete të kulturës rinisë dhe sportit të mbështetura me buxhet komunal sipas përqindjes është 87.01%, kurse hapësira për aktivitete sportive krahasuar me numrin e banoreve në komuna është 80.33%.




Figure 17 Treguesit e performancës në fushën e kulturës, rini dhe sport

### Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive

Kjo fushë matë planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera. Fusha ka vetëm një rezultat dhe dy tregues, që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nivelin e përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 53.68%.





Fig. 18 Krahasimi i performancës së komunave në fushën menaxhimi i fatkeqësive


Niveli i realizimit të treguesve për këtë fushë është si vijon: Intervenimet e për mbrojtje nga fatkeqësitë ka përqindjen 81.28 ndërsa në nivel të ulët të realizimit mbetet treguesi për realizimin e planit komunal për menaxhimin fatkeqësive prej 26.08%



**Fig.19** Treguesit e performancës në fushën e menaxhimi fatkeqësive

### Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor

Kjo fushë matë zhvillimin hapësinor komunal nëpërmjet instrumenteve të planifikimit hapësinor, por edhe nivelin e planifikimit të ndërtimeve komunale. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 55.37%.



**Figure 20** Treguesit e performancës në fushën e planifikimit hapësinor

Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese të hollësishme është në shkallë prej 26.42%. Sa i përket lejeve ndërtimore nga komunat u shqyrtuan me kohë 87.91%. Sipas të dhënave, ndërtesat e reja për të cilat u lëshuan leje ndërtimore, u inspektuar në shkallë prej 78.39%. Nga totali i objekteve të reja të inspektuara, 86.67% janë raportuar të pajisura me leje ndërtimore.




Figure 21 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e planifikimit hapësinor

### Fusha 8 – Hapësirat Publike

Kjo fushë matë hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve. Performanca e përgjithshme sipas të dhënave të ofruara nga komunat është 47.84%. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat ndër të tjera janë kompetente për ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqevë dhe hapësirave publike.




Figure 22 Treguesit e performancës në fushën e hapësirave publike

Përpos nivelit të hapësirave të gjelbra për kokë banori, kjo fushë matë edhe sipërfaqen e hapësirave publike të cilat mirëmbahen rregullisht nga komunat, si dhe numrin e hapësirave publike të përcjella me ndriçim publik. Për nivelin e përbushjes së treguesve referojuni figurës së mësipërme. Sipas të dhënave rreth 51.39% të hapësirave publike mirëmbahen rregullisht, ndërsa 67.80% të hapësirave publike janë të përcjella me ndriçim publik.




Figure 23 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e hapësirave publike

### Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore

Kjo fushë matë rrugët komunale dhe infrastrukturën përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës. Fusha është plotësuar me tregues të ri për të nxitur përmirësimin e infrastrukturës rrugore me trotuare, ndriçim, shenjzime si dhe shteg të biçikletave. Performanca e përgjithshme vlerësohet në shkallë prej 55.05%.




Figure 24 Treguesit e performancës në fushën e infrastruktura rrugore

Ajo çfarë e bënë performancën e përgjithshme të mos jetë aq e lartë, është përfshirja treguesit i ri për rrugët në zonat urbane me shtigje të biçikletave, si dhe raporti në mes të rrugëve lokale me trotuare dhe ndriçim publik. Nivelin e përbushje së treguesve të kësaj fushe e kenin në tabelën më lart. Vlen të përmendet treguesi me nivelin më të ulët, rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave 7.38% dhe treguesi me përbushjen më të lartë prej 83.73% rrugët lokale të riasfaltuara 83.73.

Performanca e komunave në nivel të fushës është paraqitur si më poshtë:




Figure 25 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e infrastrukturës rrugore

### Fusha 10 – Transporti Publik

Kjo fushë matë ofrimin e transportit publik për qytetarët e komunës. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 47.41 %.




Figure 26 Treguesit e performancës në fushën e transportit publik

Në kuadër të kësaj fushe vërejmë performancë mbi mesatare për tre tregues. Sipas të dhënave vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik 69.31%, kurse vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik qëndrojnë në nivelin 60.72%. Në nivel të ulët është përmbushur plani për transport publik i cili në përqindje është 12.21%

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




Figure 27 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e transportit publik

### Fusha 11 – Parkingjet Publike

Hapësirat për parkim publik janë vende në pronësi publike dhe private, me një numër të caktuar të vendeve të parkimit, të ndërtuara me standardet e kërkuara dhe të caktuara për parkimin e mjeteve motorike. Për më tepër, kjo fushë matë numrin e parkingjeve në komunë dhe numrin e vendparkimeve kundrejt veturave të regjistruara në komunë, po ashtu sa ka vende për taksit kundrejt numrit të taksive të licencuara dhe sa parkingje publike kanë vende të rezervuara për persona me nevoja të veçanta. Performanca në nivel të fushës është 47.35%.




Figure 28 Treguesit e performancës në fushën e parkingjeve

Krahasuar me numrin e automjeteve të regjistruara, komunat me vendparkime mbulojnë 13.05%. Shkalla e vendparkimeve të destinuar për makinat taksit të regjistruara në komuna është 69.28%. Sa i përket numrit të vendparkimeve për persona me aftësi të kufizuara 59.71% e parkingjeve i kanë të shënuara vendet e tillë. Ndërsa numri i parkingjeve publike për parkimin e mjeteve motorike është 31.70 Në vijim është paraqitur arritjet e komunave në këtë fushë në përqindje.






Figure 29 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e parkingjeve publike

## Fusha 12 - Uji i pijshëm

Kjo fushë matë sigurimin apo furnizimin e qytetarëve dhe bizneseve me ujë të pijshëm si dhe realizimin e projekteve komunale për ujë të pijshëm. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 74.60% në krahasim me vitin 2021 sa ishte 67.35%.




Figure 30 Treguesit e performancës në fushën e ujit të pijshëm në nivel vendi

Sa i përket ekonomive familjare, institucioneve publike dhe njërive biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm, ky tregues në përqindje është përmbushur prej 80.80%. Ndërsa Plani për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit në përqindje është realizuar 68.40%

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




Figura 31 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e ujit të pijshëm

Sipas figurës së mësipërme, vërejmë se 7 komuna kanë raportuar për shtrirje të rrjetit të ujit të pijshëm në 100% te ekonomitë familjare, institucionet publike dhe ekonomitë biznesore, kurse 3 komunat me të dhëna të ulëta janë Graçanicë, Partesh, Rnillug etj.

### Fusha 13 - Kanalizimi

Kjo fushë matë përfshirjen e ekonomive familjare, bizneseve dhe institucioneve në sistemin e kanalizimit si dhe realizimin e projekteve komunale për rrjet të kanalizimit. Po ashtu, ky tregues matë edhe përfshirjen e vendbanimeve të komunës në rrjetin për trajtimin e ujërave të zeza si një nga faktorët mjaft të rëndësishëm në ambient, kushte të jetesës dhe shëndetin publik. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 39.74%, për dallim nga viti 2021 sa ishte 35.49%.




Figure 32 Treguesit e performancës në fushën e kanalizimit

<sup>4</sup> Tek % totale ka ndikuar shkalla e ulët e trajtimit të ujërave të zeza. Kjo fushë është mjaft specifike dhe arritjet e plota mund të konsiderohen vetëm në rastet kur menaxhimi i ujërave të zeza përcjellët me trajtimin e tyre përmes impianteve. Në vitin 2019, kjo fushë ishte shpallur e pavlefshme, për shkak se nuk janë ofruar të dhëna të sakta, duke bërë që të dhënat të konsiderohen nule. Edhe në ato komuna ku ishte raportuar për vënien në funksion të sistemeve për trajtimin e ujërave të zeza apo impianteve, të dhënat nuk ishin raportuar të plota në lidhje me numrin e vendbanimeve të përfshira në sistemet e impianteve.

Sipas të dhënave rreth 79.91% të ekonomive familjare, institucioneve publike dhe bizneseve janë deklaruar të përfshira në sistemin e kanalizimit, për dallim nga 53.44% sa ishte në vitin 2021. Në anën tjetër, zbatimi i aktiviteteve nga plani për ndërtim dhe mirëmbajtje të sistemit të kanalizimit është raportuar të jetë 74.72% për dallim nga 60.10% sa ishte në vitin 2021.




Figure 33 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e kanalizimit

#### Fusha 14 – Menaxhimi i Mbeturinave

Kjo fushë matë mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave në komunë si dhe grumbullimin e të hyrave nga faturat e lëshuara për menaxhimin e mbeturinave. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 69.84%.




Figure 34 Treguesit e performancës në fushën e menaxhimit të mbeturinave

Të dhënat e raportuara të vitit 2022 nga komunat tregojnë se ekonomitë familjare me qasje në grumbullim të mbeturinave janë në shkallën prej 81.73%. Shkalla e inkasimit të mjeteve për grumbullimin e mbeturinave del të jetë në masën 87.68%. Ndërsa, realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave është

92.53%, sikurse Sasia e deponimit te mbeturinave ne kilogram për koke banori është 50.93%. kurse realizimi i i planit komunal pe menaxhimin e mbeturinave është përmbushur 55.23%.




Figure 35 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën menaxhimit të mbeturinave

### Fusha 15 – Mbrojtja e Mjedisit

Kjo fushë matë veprimet e komunës përkatëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 51.78%.




Figure 36 Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit

Realizimi i planit të veprimit të mjedis del të jetë arritur në masën prej 11.05%<sup>5</sup>. Lejet mjedisore të lëshuar ishin në shkallën 76.81% ndërsa ndërtesat e reja që kanë zbatuar lejet mjedisore komunale del në shkallë mjaftë të ulët prej 67.48%.

<sup>5</sup> Shumica e komunave nuk kanë dëshmuar ta kenë të hartuar Planin Lokal për mbrojtje të Mjedisit




Figure 37 Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit

### Fusha 16 – Përfaqësimi Gjinator

Përfaqësimi gjinator matet më gjerësisht në këtë fushë duke përfshirë qasjen e të dy gjinive në programet për zhvillim social, ekonomik, si dhe në aktivitetet komunale. Po ashtu, treguesit matin shkallën e përfaqësimit të të dy gjinive në institucionet lokale, trupat e kuvendëve komunale etj. Me gjithë progresin e komunave ndër vite në sigurimin e përfaqësimit të barabartë në trupat e kuvendëve dhe në komisionet komunale, të dhënat për treguesit e caktuar minimizojnë përqindjen në këtë fushë duke e bërë atë mjaft të ulët, 39.20%. Në vijim, është paraqitur figura e përfaqësimit gjinator sipas treguesve:




Figure 38 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinator

Sipas të dhënave të raportuara nga 31 komuna, niveli i të punësuarve gra në institucione komunale është 83.53% në raport me kriterin 50x50. Po ashtu, Gratë të emëruara në pozita politike, është arritur 61.57% e kriterit ligjor. Sipas të dhënave të përfaqësimit të grave në pozitat udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive, 61.74% të përmbushjes së kriterit ligjor.

Përfaqësimi gjinor tek emrat e rrugëve komunale është tejet i ulët, shprehur ne 12.21% po ashtu edhe regjistrimi i pronave në emër të një grua apo dy gjinive (bashkëshortë apo vëllezër dhe motra), është mjaftë e ulët, 7.79%.

Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor ka vlerën 45.00%. Me që ky tregues ka vlere të ulët të përkrahjes nga komunat, megjithatë, ka nevojë mjaft të madhe për trajnim në këtë drejtim si dhe për vullnet të komunave që të kuptojnë rëndësinë e kësaj çështje. Barazia gjinore në programet për punësim, subvencione dhe ndërmarrësi është në shkallë prej 41.98%.




Figure 39 Krahasimet sipas komunave në fushën e barazisë gjinor

### Fusha 17 - Arsimi Parauniversitar

Kjo fushë synon rezultate në hapësira për çerdhe dhe shkolla të pajisura me kabinete për internet, masa të efikasitetit të energjisë, rekrutimin e personelit arsimor, licencimin e mësimeve, mjetet e konkretizimit, pajisjet e shkollave me mjete mësimore, kabinete të TIK-ut, si dhe kushtet e sigurisë në shkollë. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme në nivel prej 58.39%. Në përgjithësi, në treguesit e arsimit të dhënat e raportuara nga komunat nuk kanë qenë të plota, kështu që përqindjet e fituara mund të paraqesin një vlerë relative të saktësisë.




Figure 40 % e treguesve në fushën e arsimit parauniversitar në nivel vendi

Fusha e arsimit ka me shume tregues por në grafikun me lart do ti paraqesim disa nga treguesit sipas përqindjes. Treguesi, braktisja e shkollës nga nxënësit, ku paraqitet shkalla inverse ka shënuar vlerën në 85.24%, sikurse edhe shkalla bruto e regjistrimit në klasën e parë është përbushur 81.65%. Ndersa shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit është përbushur 79.32% dhe shkalla e qasjes së tranzicionit. Kalueshmëria në testin e maturës kombëtare ka vlerën 66.18%, Kurse mësimdhënësit që i plotësojnë kriteret dhe kanë kualifikim të licencuar shprehur në përqindje janë 72.85%. Sa i përket procedurave ligjore për zgjedhjen e stafit drejtues në shkollat (9 drejtoreve dhe zv. drejtoreve) përbushja e kriterit ligjor është përbushur 64.43%, si dhe plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt, është përbushur 75.51%.




Figure 41 Krahasimet sipas komunave në fushën e arsimit parauniversitar

### Fusha 18 – Kujdesi Primar Shëndetësor

Kjo fushë matë infrastrukturën dhe hapësirat e destinuar për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunave, kjo fushë ka nivel të ulët të performancës në përgjithësi, apo 50.81%. Në vijim është paraqitur figura me % e performancës sipas treguesve në këtë fushë:




Figure 42 % e treguesve në fushën e shëndetësisë primare

Treguesit nga kjo fushë janë shumë numër, por ne do ti prezantojmë ne paraqitje grafike disa nga këta tregues, sepse janë mjaft specifik dhe me shume interes për komunat. Treguesi, fëmijë të përfshirë në programin e imunizimit është përmbushur 79.38%, kjo është një përqindje e kënaqeshe, por duhet të shkoj ne tendence të rritjes në vitet e ardhshme. Sikurse ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra e fëmijë është përmbushur 83.33%. Ndërsa tregues që kanë të bëjnë me ngritjen e nivelit të kushteve infrastrukturore janë si vijon: Objekte të KPS që janë të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike janë përmbushur 56.57%, ndërsa m<sup>2</sup> hapësirave të KPS për 1000 banorë, ka vlerën



prej 56.57%. Kurse niveli i pajtueshmërisë me raportin një mjek familjar edhe dy infermier për 2000 banore, në nivel te komunave është arritur 56.57, krahasuar me vitin 2021 prej 41.96 %, apo 14.61 më e lartë në vitin 2022

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




Figure 43 Krahasimet sipas komunave në fushën e shëndetësisë primare

### Fusha 19 – Zhvillimi Ekonomik Lokal

Kjo fushë mate aktivitetet e planifikuara dhe të zbatuara për zhvillimin e aktivitetit ekonomik në nivel lokal duke mobilizuar pronat komunale, dhe përditësim i rregullt i regjistrit të tatimpaguesve si dhe shkallë e lartë e inkasimit e tatimit në prone. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme prej 56.38% në vitin 2022, apo 44.55% në vitin 2021, ose më lartë se në vitin praparak 11.83%




Figure 44 e treguesve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

Fusha e Zhvillimit Ekonomik Lokal është prezantuar nga 4 tregues ne grafikun me lartë. Plani pe zhvillim ekonomik lokal është përmbushur nga komunat 21.67%. Kurse niveli i mbledhjes se faturës se tatimit ne

prone pa borxhe interes dhe ndëshkime është përmbushur në 52.34%. Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale në shfrytëzim është përmbushur në 75.00%. Kurse niveli i azhurnimit të regjistrimit të tatimit në prone është përmbushur në 76.53% apo më lartë se në vitin praparak prej 25.87%.




Figure 45 Krahasimet sipas komunave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

## Konkluzione dhe rekomandime

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2022 nxjerr të gjetura të shumta për 19 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal. Në këtë pjesë të raportit, janë veçuar disa nga konkluzionet dhe rekomandimet me peshë më të madhe në avancimin e shërbimeve komunale. Raporti nxjerr përfundimet se:

1. Vlerësimi i performancës së komunave për vitin 2022 është bërë për 30 komuna<sup>6</sup>. Disa nga të dhënat e raportuara nga komunat me shumicë serbe, në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, të cilat nuk korresponduan me ofrimin e shërbimeve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës, janë shpallur nule dhe u aplikua vlera 0% e performancës. Matja dhe vlerësimi i performancës është obligim ligjor i të gjitha komunave, të cilat duhet t'i përgjigjen kërkesave për informata konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Sistemin e Menaxhimit të Performancës komunale. Komuna e Skenderajt nuk ka raportuar për vitin 2022.
2. Komunat duhet t'i kushtojnë vëmendje të gjitha të dhënave të prezantuara për raportim, në mënyrë që vlerat e fituara të paraqesin vlerësimin sa më objektiv të performancës për çdo tregues. Dokumentimi i të dhënave është kusht i domosdoshëm. Gjatë përgatitjes së të dhënave dhe informatave, komunat duhet të përgatisin dosjen për secilën fushë
3. Procesi i sigurimit të cilësisë ka evidentuar një numër të të dhënave të pasakta, të cilat në shumë raste janë shpallë të pavlefshme, përveç atëherë kur është bërë dokumentimi i tyre. Cilësia e raportimit duhet të rritet në të ardhmen, ashtu që raportimi të jetë i drejtë, i saktë, objektiv dhe të paraqes gjendjen sa më reale të performancës së komunave.
4. Performanca është kategorizuar në dy grupe me tregues të cilës pasqyrojnë veprimet e komunave në funksion të qeverisjes së mirë dhe ofrimin të shërbimeve. Në kuadër të grupit të indikatorëve të qeverisjes, Shërbimet Administrative renditet e para, megjithëse treguesi për pasqyrimin e rezultateve të konsultimeve publike duhet të trajtohet seriozisht nga autoritetet lokale. 33.12% e komunave kanë filluar me hartimin e këtyre raporteve (Gjilani, Gillogoci, Hani i Elezit, Juniku, Kaqaniku, Kamenica, Klina, Lipjani, Malisheva, Mitrovica e Jugut, Obiliqi, Peja, Podujeva, Prizreni, Rahoveci Skenderaj, Suhareka Podujeva, Rahoveci). Raportet e proceseve të konsultimeve publike duhet të përpilohen për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në politik bërja dhe marrjen e opinionit të tyre për çështje publike.
5. Prezenca e qytetarëve në konsultimet publike ka vazhduar të jetë e ulët. Komunat duhet të shfrytëzojnë teknika dhe mjete efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrësit.
6. Performancë e ulët është treguar në fushën e përfaqësimit gjinor. Komunat duhet të ndër marrin veprime për ta rritur numrin e grave në pozita vendimmarrëse, politike dhe në këshillat lokale. Po ashtu, duhet të përmirësohen dokumentet planifikuese dhe financiare duke marrë për bazë elementin gjinor.
7. Një pjesë e komunave kanë filluar aplikimin online të shërbimeve administrative, performanca në këtë segment duhet të përmirësohet, për të ngritur efikasitetin në shërbime dhe me kosto sa më të ulët. Këto shërbime duhet të aplikohen në të gjitha komunat dhe për numër më të madh të shërbimeve, përfshirë aplikimin online për leje ndërtimore, leje mjedisore, pagesat e tatimit në pronë, apo faturat për shërbime komunale etj.
8. Të dhënat për barazinë në punësim dhe shërbimet sociale tregojnë se drejtoritë komunale duhet të bëjnë përpjekje për përfshirje të të gjitha kategorive në nevojë në politikat e

---

<sup>6</sup> Komunat: Ferizaj, Novobërdë, Shtërpçë, Zubin Potok. Leposaviq, Zveçan. Mitrovica e Veriut, Klllokot.

- punësimit. Gjithashtu efikasiteti duhet të rritet në vlerësimin e familjeve në banim social, në mënyrë që të objektet e banimit social të shfrytëzohen nga familjet në nevojë dhe të ketë shqyrtim të plotë të kërkesave të parashtruara;
9. Planifikimi hapësinor kërkon trajtim më të gjerë për të rregulluar të gjithë sipërfaqet e nevojshme me plane rregulluese të hollësisht ose me harta zonale. Të dhënat flasin për një shkallë mjaft të ulët të këtyre planeve të cilat janë tejet të rëndësishme për rregullimin e komunës;
  10. Infrastruktura rrugore duhet të kompletohet, si në aspektin e asfaltimit të rrugëve, ashtu edhe me infrastrukturë përcjellëse përfshirë trotuare dhe ndriçim publik. Komunitat duhet të rrisin cilësinë e të dhënave për nivelin e asfaltimit të rrugëve, trotuaret, ndriçimin e tyre, e sidomos tek të dhënat për shtigjet e biçikletëve. Po ashtu, nevojitet planifikim më i mirë në mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale, në mënyrë që shtrirja me këtë shërbim të jetë e plotë.
  11. 7.38% e të dhënave për shtigje të biçikletave në zonat urbane, është vlerë që tregon se komunitat duhet të punojnë në avancimin e infrastrukturës rrugore përmes krijimit të shtigjeve të biçikletave.
  12. Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit, komunitat duhet të përpilojnë dhe të formulojnë pjesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor sipas kriterëve ligjorë. Politikat lokale duhet të vlerësojnë ndikimin gjinor, ashtu që burimet financiare të ndahen proporcionalisht për të dy gjinitë. Kërkohej promovim më i madh i politikave gjinore në këshillat e lokale. Komunitat duhet të të hartojnë planet për barazi gjinore. Po ashtu kriteri i barazisë gjinore duhet të forcohet edhe në kuadër të pozitave të emëruara politike, si dhe të promovohet e drejta për regjistrimin e pronësisë në të dy gjinitë e cila qëndron në vlerë mjaft të ulët.
  13. Komunitat duhet të fillojnë të investojnë në çerdhe/kopshte në zona rurale ku ka nevojë, për shkak të rëndësisë së këtyre institucioneve në zhvillimin e hershëm të fëmijëve.
  14. Drejtoritë komunale të arsimit duhet të planifikojnë që shkollat të plotësojnë kushtet e infrastrukturës përcjellëse, masat e energjisë eficiente, si dhe të jenë të pajisura me kabinate me internet në masë më të madhe. Krijimi i hapësirave shkollore sidomos në zonat urbane kërkojnë trajtim të veçantë për të eliminuar mësimin në më shumë turne dhe aplikimin e mësimin gjithë-ditor. Edhe në fushën e arsimit, është e domosdoshme të rritet cilësia e raportimit dhe saktësisë së të dhënave.
  15. Planifikimi formal për zhvillim ekonomik lokal duhet të zgjerohet në komuna. Komunitat duhet të hartojnë Planet për Zhvillim Ekonomik Lokal. Raportimi për realizimin e planeve të tilla duhet të jetë temë e diskutimit në kuvendet komunale, në mënyrë që të aktivitetet në këtë fushë të gjejnë zbatim më të lehtë dhe të renditen sipas kërkesave të shumicës.
  16. Duhet të inkurajohen komunitat që të resepektohen rregullat ligjore, për ta ngritur cilësinë e raportimit dhe ngritjen e cilësisë së referencimit sa i përket dokumenteve adekuate për çeshtje të caktura.
  17. Duhet tu bëhet me dije të gjitha komunave të Republikës së Kosovës se, përfromanca si instrument përveç që është mundësi për marrje të fondeve, është edhe obligim ligjor që të aplikohet raportimi i plotë për të gjithë treguesit.

Shtojcë: % e treguesve sipas fushave

Shërbimet Publike Administrative	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit Administrativni zahtevi koji su razmatrani tokom godine	93.06
	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	96.66
	1.1.4	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	74.40
Transparenca Komunale	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online	81.74
	2.1.2	Niveli i qasje në dokumente publike nga qytetarët Niveli i qasje në dokumente publike nga qytetarët	93.54
	2.1.3	Përmbushja e kriteve të faqes zyrtare elektronike të komunës Përmbushja e kriteve të faqes zyrtare elektronike të komunës	83.33
	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqen zyrtare të komunës Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqën zyrtare të komunës	91.12
	2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqën zyrtare të komunës	81.19
	2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	85.33
	2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave	86.76
	Përgjegjshmëria Komunale	3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike
3.1.2		Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	35.26
3.1.3		Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	58.94
3.1.4		Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal	90.13
3.1.5		Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	33.12
3.1.6		Këshillat lokal që kanë mbajtur së paku 6 takime në vit Local councils that have held at least 6 meetings a year	40.62
3.2.1		Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	85.00
3.2.2		Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal	73.33
3.2.3		Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak	60.00
3.2.4		Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunal Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunal	75.00
3.2.5		Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Kuvendin Komunal Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Asambleshë Komunale	30.00

	3.2.6	Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	71.15
	3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	89.82
	3.3.2	Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	59.31
	3.3.3	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	46.67
	3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	43.33
	3.5.1	Zbatimi i skemës për shpërndarjen e vlerësimeve të punës për shërbyesit civil	72.17
	3.5.3	Kontratat për shërbime të veçanta janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	93.33
Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare	4.1.1	Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	27.85
	4.1.2	Të punësuar nga komunitetet jo-shumicë Të punësuar nga komunitetet jo-shumicë	53.23
	4.2.1	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social	69.13
	4.2.2	Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar	90.99
Kulturë, Rini dhe Sport	5.1.1	Hapësira për aktivitete sportive për numër të banorëve Hapësira për aktivitete sportive për numër të banorëve	80.33
	5.2.1	Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	87.01
Menaxhimi i fatkeqësive	6.1.1	Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive	26.08
	6.1.2	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë	81.28
Planifikimi Hapësinor	7.1.1	Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme) Sipërfaqja e territorit të komunës i mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme)	26.42
	7.2.1	Kërkesa të shqyrtura për leje të ndërtimit Kërkesa të shqyrtura për leje të ndërtimit	87.91
	7.2.2	Ndërtesa të reja të inspektuara Ndërtesa të reja të inspektuara	78.39
	7.2.3	Objekte të reja me leje të ndërtimit Objekte të reja me leje të ndërtimit	86.67
Hapësirat Publike	8.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m2 për kokë banori Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m2 për kokë banori	24.32
	8.1.2	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	51.39
	8.1.3	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	67.80
Infrastruktura Rrugore	9.1.1	Rrugët lokale të shtruara Rrugët lokale të shtruara	76.99
	9.1.2	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	57.45

	9.1.3	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	62.21
	9.2.1	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	24.28
	9.2.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	47.67
	9.2.3	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	59.64
	9.2.4	Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave	7.38
	9.2.5	Rrugët lokale të riasfaltuara Rrugët lokale të riasfaltuara	83.73
Transporti Publik	10.1.1	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik Realizimi i planit komunal për transport lokal publik	12.21
	10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	69.31
	10.1.3	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	60.72
Parkingjet Publike	11.1.1	Numri i parkingjeve për parkimin e mjeteve motorike Numri i parkingjeve për parkimin e mjeteve motorike	31.70
	11.1.2	Vendparkimet për mjete motorike në territorin e komunës Vendparkimet për mjete motorike në territorin e komunës	13.05
	11.1.3	Vendparkimet e destinuar për taksit Vendparkimet e destinuar për taksit	69.28
	11.1.4	Numri i parkingjeve me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara Numri i parkingjeve me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara	59.71
Uji i pijshëm	12.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit Implementation of the plan for construction and maintenance of the water supply system	68.40
	12.1.2	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm Households, public institutions and business units involved in the drinking water system	80.80
Kanalizimi	13.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	74.72
	13.1.2	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit	79.91
	13.2.1	Vendbanimet e përfshira në sistemin për trajtim të ujrave të zeza	2.17
Menaxhimi i Mbeturinave	14.1.1	Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	55.23
	14.1.2	Ekonomitë familjare që kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave Ekonomitë familjare që kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	81.73
	14.2.1	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	92.53
	14.2.2	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	87.68
	14.3.1	Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori	50.93
Mbrojtja e Mjedisit	15.1.1	Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis	12.26
	15.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara Lejet mjedisore komunale të lëshuara	76.81

	15.1.3	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	67.48
Përfaqësimi Gjinator	16.1.1	Gratë e punësuar në institucione/administratën komunale Gratë e punësuar në institucione/administratën komunale	83.53
	16.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive	61.74
	16.1.3	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	61.57
	16.1.4	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	72.88
	16.1.5	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	13.12
	16.2.1	Buxheti dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinator Buxheti dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinator	45.00
	16.2.2	Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	41.98
	16.2.3	Pjesëmarrja e grave në konsultime publike Pjesëmarrja e grave në takime publike	42.52
	16.2.4	Plani komunal për barazi gjinore Plani komunal për barazi gjinore	66.67
	16.3.1	Barazia gjinore tek emërtimet e rrugëve Barazia gjinore tek emërtimet e rrugëve	12.21
	16.3.2	Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	7.79
	Arsimi Parauniversitar	17.1.1	Çerdhe dhe kopshte publike në zona rurale për 10000 banorë Çerdhe dhe kopshte publike në zona rurale për 10000 banorë
17.1.2		m2 të hapësirave shkollore për kokë nxënësi – urban dhe rural m2 të hapësirave për nxënës – urban dhe rural	7.28
17.1.3		Shkollat e pajisura me kabinet te TIK (Teknologji Informative dhe Kompjuterike) Shkollat e paisura me kabinet te TIK	63.38
17.1.4		Shkollat me masa te eficiencës së energjisë Shkollat me masa te eficiencës së energjisë	59.69
17.1.5		Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	74.14
17.1.6		Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, paisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, paisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	49.25
17.2.1		Mësimdhënësit që i plotësojnë kriteret e kualifikimit të licensuar Mësimdhënësit që i plotësojnë kriteret e kualifikimit të licensuar	72.85
17.2.2		Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës - urban dhe rural Niveli i pajtueshmërisë me raportin nxënës për mësimdhënës - urban dhe rural	54.75
17.2.3		Plotësimi i buxhetit për arsim prej të hyrave vetanake Plotësimi i buxhetit për arsim prej të hyrave vetanake	3.81
17.2.4		Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt	75.51
17.2.5		Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs plotësues Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs plotësues	69.78
17.2.6		Respektimi i procedurave ligjore për zgjedhjen e stafit drejtues të shkollave (drejtorëve dhe zv.drejtorëve) Respektimi i procedurave ligjore për zgjedhjen e stafit drejtues të shkollave (drejtorëve dhe zv.drejtorëve)	64.43



	17.3.2	Shkalla bruto e regjistrimit ne kl.1 Shkalla bruto e regjistrimit ne kl.1	81.65
	17.3.3	Shkalla e qasjes – tranzicioni kl9- kl10 Shkalla e qasjes – tranzicioni kl9- kl10	77.69
	17.3.4	Rezultatet e testit të arritshmërisë për kl.9-ta Rezultatet e testit të arritshmërisë për kl.9-ta	47.92
	17.3.5	Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12-të (ndarja sipas gjinisë) Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12-të (ndarja sipas gjinisë)	66.18
	17.3.7	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse) Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	85.24
	17.3.8	Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit	79.32
Kujdesi Primar Shëndetësor	18.1.1	m2 të hapësirave KPS për 10000 banorë m2 të hapësirave KPS për 10000 banorë	56.57
	18.1.2	Objektet e KPS që janë të paisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike Objektet e KPS që janë të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike	49.96
	18.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë	54.08
	18.2.2	Përqindja e buxhetit për kujdes primar shendetësor të mbështetur nga komunat prej të hyrave vetanake Përqindja e buxhetit për kujdes primar shendetësor të mbështetur nga komunat prej të hyrave vetanake	4.06
	18.3.1	Numri i vizitave të pacientëve në kujdesin primar shëndetësor për kokë banori Numri i vizitave të pacientëve në kujdesin primar shëndetësor për kokë banori	47.56
	18.3.2	Fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit Fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit	79.38
	18.3.3	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra dhe femijë Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe femijë	83.33
Zhvillimi Ekonomik Lokal	19.1.1	Plani për zhvillim ekonomik lokal Plani për zhvillim ekonomik lokal	21.67
	19.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	75.00
	19.1.3	Niveli i azhurnimit të regjistrimit të tatimit në pronë Niveli i azhurnimit të regjistrimit të tatimit në pronë	76.53
	19.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime) Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	52.34

